



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Nënk. Orig. Orig. / Orig.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. / Prot.	415
Nr. / Niveli Dok. / Niveli Reg. / Niveli	3	Emri Emri / Emri Emri / Emri	31.12.09

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-129 për zonat ekonomike, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2009/25

PËR PROCEDURAT E KONTROLLIT TË ZONAVE EKONOMIKE

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim administrativ përcakton procedurat dhe veprimet e ndërmarra për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e zonave ekonomike.

Neni 2
Përkufizimet

1. Në kuptim të këtij Udhëzimi termat e përdorur në vijim kanë këto kuptime:

1.1. **Agjencia** - nënkupton Agjencinë për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;

1.2. **NMVM** - nënkupton ndërmarrjet mikro, të vogla apo të mesme;

1.3. **ZE** - nënkupton Zonat Ekonomike;

1.4. **Institucioni Kompetent** - nënkupton Shërbimin Policor të Kosovës, Shërbimin Doganor të Kosovës, Inspektoratet përkatëse dhe Administratën Tatimore të Kosovës.

Neni 3 **Procedurat e kontrollimit**

1. Agjencia ka kompetencë të plotë për kontrollimin dhe monitorimin e ZE, për të cilën nuk është e detyruar ta njoftoj zhvilluesin.

2. Agjencia detyrohet:

- 2.1. Të bëjë mbikëqyrjen e kushteve të vendimit;
- 2.2. Të kontrolloj dokumentet, dëshmitë dhe informatat, si dhe të kërkoj nga zhvilluesi/operatori menaxhues dhe shfrytëzuesi që të përgatisin kopjet dhe dokumentet e kërkuara;
- 2.3. Të kërkoj vërtetësinë e kopjeve me origjinalin e dokumenteve, dëshmime dhe informatave të marra nga zhvilluesi/operatori menaxhues, me nënshkrimin dhe vulën e vet;
- 2.4. Të bëjë monitorim të rregullt të ZE nëpër të gjitha fazat e zhvillimit;
- 2.5. Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike për operimin efikas të zonës ekonomike përfshirë: objektet, furnizimin me ujë, energji elektrike, telekomunikimit, rrugëve, kanalizimit, parkingjeve, ngrohjes dhe gazit;
- 2.6. Të detyroj zhvilluesin për riparimet eventuale të dëmtuara, konform paragrafit 2.5 të këtij neni;
- 2.7. Të përpiloj raport për kontrollimin dhe monitorimin e kryer në ZE.

Neni 4 **Bashkëpunimi ndërmjet Zhvilluesit dhe Agjencisë në fushën e kontrollimit të ZE**

1. Zhvilluesi/operatori menaxhues bashkëpunon me Agjencinë dhe për aktivitetet e paligjshme brenda ZE, është i detyruar që të lajmëroj Agjencinë dhe institucionin kompetent.

2. Moslajmërimi me kohë për aktivitetet e paligjshme të parapara në paragrafin 1 të këtij neni sanksionohet konform dispozitave ligjore në fuqi.

3. Zhvilluesi/operatori menaxhues duhet:

- 3.1. Të hartoj raportin vjetor brenda 3 muajve të parë të vitit vijues lidhur me zhvillimet rreth funksionimit të ZE dhe të njëjtin ia dorëzon Agjencisë;
- 3.2. Të njoftoj për vendosjen e çdo shfrytëzuesi, biznesi të ri në ZE;
- 3.3. Të informoj ad-hoc rreth vështirësive që paraqiten gjatë funksionimit të ZE.

Neni 5

1. Nëse agjencia gjatë kontrollimit dhe monitorimit konstaton se nuk janë respektuar kushtet e vendimit të lëshuar për krijimin e ZE, atëherë zhvilluesit i jepet një afat prej 60 ditësh që t'i evitoj parregullsitë.
2. Nëse pas 60 ditësh konstatohet se zhvilluesi nuk i ka evituar parregullsitë, atëherë Agjencia inicon procedurën për ndryshimin e vendimit konform ligjit për zonat ekonomike.
3. Në rast se vërtetohet se zhvilluesi ka kryer shkelje të ligjit, akteve nënligjore ose rregullores së zonës, atëherë do të veprohet konform ligjit të zonave ekonomike.
4. Nëse parregullsitë janë hasur të shfrytëzuesi dhe nëse ato edhe pas 60 ditësh nuk i ka evituar zhvilluesi, atëherë Agjencia urdhëron zhvilluesin që brenda 24 orëve të bëjë ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzuesit, në të kundërtën konsiderohet parregullsi e zhvilluesit.
5. Agjencia njofton institucionin kompetent për parregullsitë e hasura dhe kërkon intervenimin e tyre, në qoftëse se vet nuk është e autorizuar drejtpërsëdrejti të ndërmarr masat përkatëse.

Neni 6 **Dispozitat kalimtare**

Mbikëqyrjen për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ e bënë Agjencia për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro të vogla apo të mesme.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 31.12.2009

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

